

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

URDHËR

Nr. 45 Dt. 5. 5. 99

Sot ne dt. 04.05.1999, unë Arben Rakipi, Prokuror i Përgjithshëm, me qellim për te forcuar bashkëpunimin ndërmjet strukturave te policisë dhe prokurorisë ne hetimin e veprave penale dhe për te rritur interesimin e policisë për hetimin e veprave penale, me qellim për te evituar ripërsëritjen e veprimeve hetimore qe kryhen ne prokurori, bazuar ne nenin 24 te Kodit te Procedurës Penale

URDHËROJ:

- 1- Ne te gjitha rastet kur ndjekja penale do te filloje me materiale te ardhura nga policia, pavarësisht nëse janë mbi baze flagrante, vendngjarje apo denoncimi, prokurori do te përfshijë ne hetimin e ceshtjes edhe, te paktën, 1 (një) prej oficerëve te policisë gjyqësore te komisariateve, i cili (te cilët) ka kryer veprimet e para.
- 2- Ne asnjë rast te mos lejohet nga prokuroret qe oficeret e policisë gjyqësore te prokurorive te përsërisin veprimet e kryera nga koleget e tyre te komisariateve. Përsëritja do te lejohet veçse kur është e domosdoshme për efekte ballafaqimesh, rindërtim vendi ngjarjeje, etj.
- 3- Çdo tre muaj prokuroret e retheve te informojnë Prokurorin e Përgjithshëm për cilësinë e punës se oficerëve te policisë gjyqësore te komisariateve dhe për probleme te tjera qe do te rezultojnë nga puna e tyre. Informacioni te shoqërohet me propozime nëse ata janë ne gjendje te mbajnë titullin e oficerit te policisë gjyqësore apo jo.
- 4- Ne formularët e statistikave 3- mujore qe dërgohen ne Prokurori te Përgjithshme te pasqyrohet ne një flete me vete ngarkesa e punës për oficeret e policisë gjyqësore te Prokurorive dhe Komisariateve.
- 5- Ky urdhër ka efekt edhe për procedimet ne dore.

- 6- Ky urdhër tu shpërndahet prokurorive te rretheve dhe prokuroreve ne Prokurorinë e Përgjithshme.
- 7- **Një kopje e këtij urdhri t'i dërgohet Ministrisë se Rendit Publik për t'ua bere te njohur strukturave te Policisë.**

PROKURORI I PERGJITHSHEM

ARBEN RAKIPI



